

**AKTI I THEMELIMIT
TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“THRIVE” shpk**

Sot, në datë 27.04.2022, unë themeluesi, Jonida Xhema, atësia Jakup, shtetase kosovare, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal 1170952738, i datëlindjes 22.04.1995, lindur në Prishtinë dhe banues në Tiranë madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar sipas kushteve të mëposhtëme.

**Neni 1:
Themelimi**

- 1) Emri i shoqërisë është “THRIVE” shpk.
- 2) Shoqëria themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar në përputhje me legjislacionin shqiptar.
- 3) Shoqëria fiton personalitet juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**Neni 2:
Objekti**

- 4) Shoqëria do të kryejë aktivitetin e saj në fushën e :
 - a) Shitje online e produkteve didaktike, fletore, nepermjet platformes Amazon.
 - b) Te tjera
- 5) Shoqëria, në të ardhmen, gjithashtu mund të zhvillojë çdo aktivitet tjetër të ligjshëm dhe që e gjykon të nevojshme.

**Neni 3:
Kohëzgjatja**

- 1) Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar.

**Neni 4:
Selia**

- 1) Shoqëria e ka selinë në: Rruga Eshref Frasherit, Pallati nr.9, Kati 4, Apartamenti 19, Tiranë.
- 2) Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 5:
Kapitali themeltar**

- 1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 6,000 (Gjashtë mijë) Lekë dhe është i ndarë në 1 (nje) kuotë, që zotërohet plotësisht nga ortaku Jonida Xhema.
- 2) Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).



Neni 6:
Administratori

- 1) Administrator i shoqërisë emërohet zj. Melisa Xhaferi, atësia Agron, shtetas shqiptar, identifikuar me letërnjoftimin me numër personal K15405021L i datëlindjes 05.04.2001, lindur në Tepelene dhe banues në Tirane me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e emërimit.

Neni 7:
Baza Ligjore

- 1) Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 2) Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 8:
Mosmarrëveshjet

- 1) Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

ORTAK I VETËM
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“THRIVE” shpk

Jonida Xhema

(Emër, Mbiemër, Firma)

